



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:230766

Datë: 20.12.2024

Numri i dokumentit: 06634881

C.nr.406/19

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, rruga “Lidhja e Pejës” Magjistratja Prishtinë- Fushë Kosovë, p.nr., të cilën e përfaqëson me autorizim D.H, kundër të paditurit F.R nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti rimbursim dëmi, me vlerë të kontestit 635.00 € (gjashtëqind e tridhjetë e pesë euro), pas përfundimit të shqyrtimit kryesor e publik me datë 18.12.2024, në prezencë të përfaqësueses së paditëses dhe të paditurit, me datë 20.12.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË POHIMIT

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, rruga “Lidhja e Pejës”.

II. DETYROHET i padituri F.R nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, që për dëmin e shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 26.06.2017, në rrugën tranzit ... më saktësisht në fshatin ..., me automjetin e udhëtarëve “...”, me targa ..., paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), në emër të rimbursimit të dëmit, t’ia paguaj shumën prej 635.00 € (gjashtëqind e tridhjetë e pesë euro), me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë (11.07.2019) e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 170.00 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, rruga “Lidhja e Pejës” Magjistratja Prishtinë- Fushë Kosovë, p.nr, përmes të autorizuarit të saj, me datë 11.07.2019, ka parashtruar padi për rimbursimin e dëmit, kundër të paditurit F.R nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë. Ka theksuar se i padituri me datë 11.07.2019, me policë të skaduar të sigurimit, duke drejtuar automjetin e udhëtarëve “...”, me targa ..., në fshatin ..., Komuna e Prishtinës, ka shkaktuar aksident të komunikacionit duke e goditur automjetin kamionetë “...” me targa ..., pronë e të dëmtuarit B.P, të cilit i shkakton dëme materiale. Po ashtu ka theksuar se të dëmtuarit në fjalë ia ka kompensuar dëmin, andaj në bazë të Ligjit nr.04/L-018 për Sigurimin e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia dhe të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ka të drejtë në kthimin e shumës së paguar, duke kërkuar rimbursimin e dëmit në shumën prej 635.00 € (gjashtëqind e tridhjetë e pesë euro), me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata me datë 15.10.2024, ka mbajtur seancën përgatitore në të cilën përfaqësuesi i paditëses ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurin që në emër të rimbursim të dëmit, paditëses t’ia paguaj shumën prej 635.00 euro, e po ashtu të paditurit ia ka ofruar mundësinë për zgjidhjen e kontestit me marrëveshje dhe që shumën e kërkesëpadisë ta paguaj në këste mujore.

I padituri fillimisht e ka kundërshtuar padinë e paditëses me pretendimin se i njëjti nuk është përgjegjës për shkaktimin e aksidentit, por përgjegjës është drejtuesi i veturës B, B.P, sepse i njëjti ka dalur nga oborri i tij nga ana e djathtë në anën e majtë, e pastaj menjëherë është kthyer në të djathtë për tu kyçur në rrugë, dhe i padituri duke u munduar ta evitonte aksidentin, ka theksuar se e ka lëshuar rrugën dhe e ka goditur murin si dhe një pjesë të veturës së B.P, si dhe ka theksuar se nuk pajtohet me përshkrimin siç është dhënë në raportin e aksidentit të policisë.

Me qëllim të vërtetimit të saktë të bazës juridike të kërkesëpadisë së paditëses, përkatësisht për të konstatuar kontributin e pjesëmarrësve në shkaktimin e aksidentit, gjykata me propozimin e palës paditëse ka angazhuar ekspertin e komunikacionit S.B. Eksperti e ka përpiluar ekspertizën me datë 16.11.2024, në të cilën ka konstatuar se i padituri është shkaktar i aksidentit. Gjykata ka mbajtur seancën kryesore me datë 18.12.2024, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e paditëses, i padituri dhe eksperti S.B.

Përfaqësuesja e paditëses përgjatë seancës kryesore ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se meqenëse është konstatuar përgjegjësia e të paditurit në ekspertizën e komunikacionit, me qëllim të ekonomizimit të procedurës dhe mos zvarritjes së saj, i ka ofruar mundësinë palës së paditur që këtë çështje juridiko-kontestimore ta zgjidhin me pajtim gjyqësor, duke ia mundësuar që shumën e rimbursimit ta paguaj në këste mujore, ku shuma e këstit do të ishte 30 euro. Në fjalën përfundimtare gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses dhe të detyrohet i padituri që paditëses, t’ia rimbursoj shumën prej 635.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të taksës gjyqësore për padi vlerën prej 20 euro, ndërsa në emër të ekspertizës së komunikacionit shumën prej 150 euro.

I padituri F.R, përgjatë seancës kryesore ka theksuar se është i gatshëm që të lidhë marrëveshje gjyqësore me paditësen dhe t’ia paguaj shumën prej 630.00 euro, por jo edhe shpenzimet për nxjerrjen e ekspertizës në shumën prej 150.00 euro. Edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e kundërshton kërkesëpadinë e paditëses sa i përket shumës së rimbursimit, por nuk ka pranuar që t’i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 170 euro.

Gjykata në bazë të lartcekurave e duke marrë parasysh se kërkesëpadia e paditëses është pohuar nga i padituri, bazuar në nenin 148 par 1 dhe 2 të LPK-së ku përcaktohet se “Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimin në bazë të pohimit).

Gjykata në kuptim të nenit 148.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, pas pohimit të kërkesëpadisë nga i padituri, ka konstatuar se në rastin konkret është fjala për kërkesa me të cilat palët mundë të disponojnë lirisht, prandaj në kuptim të nenit 148.1 të LPK-së gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara, i referohen taksës për padi në shumën prej 20 euro dhe për përpilimin e ekspertizës shumën prej 150 euro, në shumën totale prej 170 euro.

Andaj, bazuar në të lartcekurat dhe konform neneve 143 dhe 148 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil

C. nr.406/19, me datë 20.12.2024

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.